



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
ZYRA E KOORDINATORIT KOMBËTAR PËR LUFTËN KUNDËR
TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE**

**STRATEGJIA KOMBËTARE E LUFTËS KUNDËR TRAFIKIMIT TË QENIEVE
NJERËZORE**

2008 - 2010

PASQYRA E LËNDËS

KUADRI STRATEGJIK	3
Hyrje.....	3
Kapitulli I – Analizë e përgjithshme e situatës	4
Konteksti.....	4
Arritjet aktuale.....	5
Sfidat që mbeten për t’u kapërcyer.....	6
Kapitulli II – Vizioni, përparësitë dhe synimet	7
Kapitulli III – Politikat që duhen ndërmarrë	8
Përkufizimet ligjore ku mbështetet Strategjia kundër Trafikimit të Fëmijëve:.....	9
Kapitulli IV – Buxheti	10
Kapitulli V – Monitorimi dhe analiza e vlerësimit	10
Aneksi I: Një pasqyrë e kuadrit kombëtar për bashkëpunimin dhe koordinimin ndërmjet aktorëve anti-trafik	12
Struktura Kombëtare Koordinuese për parandalimin, dhënien e ndihmës dhe mbrojtjen – ndarje e detyrave (do të qartësohet nga Grupi ad-hoc i ekspertëve):.....	13
Niveli Kombëtar:.....	13
Aktorët në nivel rajonal:.....	14
Niveli në Bashki/Komuna:.....	14
Aneksi II - Kuadri ligjor shqiptar ku mbështetet Strategjia	16
Fjalorth i Shkurtimeve	19
Kuadri Operacional	21
I. NDJEKJA dhe DREJTËSIA PENALE.....	21
II. MBROJTJA.....	39
III. PARANDALIMI.....	58
IV. BASHKËRENDIMI.....	79

KUADRI STRATEGJIK

Hyrje

Megjithëse përbën një vepër të rëndë penale, trafikimi i qenieve njerëzore është pikësëpari e mbi të gjitha një shkelje e të drejtave njerëzore të personave të prekur; mund të luftohet vetëm përmes një mënyre gjithëpërfshirëse dhe shumë-disiplinore, me përfshirjen e gjerë të aktorëve shtetërorë dhe veçanërisht jo-shtetërorë nga një larmi fushash dhe formimesh.

Kjo Strategji dhe Plani i Veprimit kundër trafikimit është një instrument për të gjithë aktorët shtetërorë dhe jo-shtetërorë, si dhe partnerët ndërkombëtarë, në një kuptim të përbashkët të situatës së trafikimit të qenieve njerëzore, sfidave që shtrihen përpara dhe përballimin e tyre. Kjo e fundit parashtron bashkëpunimin dhe bashkërendimin mes të gjithë aktorëve, rolet dhe përgjegjësitë e tyre përkatëse, për të arritur në një qasje efikase dhe të harmonizuar. Në këtë mënyrë, shpresohet që Strategjia dhe Plani i Veprimit do të shërbejnë gjithashtu për të siguruar si mbështetjen e nevojshme politike ashtu edhe atë financiare për zbatimin e masave të parashikuara.

Strategjia dhe Plan Veprimi 2008 - 2010 janë hartuar në një proces konsultimi me të gjithë aktorët e përfshirë, shtetëror, jo-shtetëror dhe donatorë ndërkombëtar. Gjatë muajve shkurt-prill 2008, janë zhvilluar një sërë takimesh konsultative dhe seminare mbi tema specifike të Strategjisë dhe Planit të Veprimit dhe kontribute dhe sugjerime janë mbledhur nga organizata dhe agjencitë ndërkombëtare. Gjithashtu, janë marrë parasysh studime dhe raporte vlerësimi përkatëse. Një projekt Strategji dhe Plan Veprimi u miratua nga të gjithë aktorët gjatë një seminari kombëtar të mbajtur më 14 maj 2008, dhe u finalizua me prurjet nga të gjithë aktorët e përfshirë.

Strategjia dhe Plani i Veprimit 2008-2010 u prezantua në Konferencën Kombëtare të zhvilluar më datë 30 maj 2008 dhe u miratua në parim nga Komiteti Shtetëror për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore në takimin e zhvilluar më datë 6 qershor 2008. Ajo gëzon kështu mbështetjen dhe angazhimin e plotë të të gjithë aktorëve të përfshirë.

Zyra e Koordinatorit Kombëtar gjatë procesit të hartimit të strategjisë u asistua vazhdimisht nga dy ekspertë me përvojë në hartimin e dokumenteve strategjik, me ekspertizë të veçantë në fushën e mbrojtjes dhe trafikimit të fëmijëve. Në këtë proces, Zyra mori mbështetjen e Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimet, UNICEF, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), dhe Qendra Ndërkombëtare për Zhvillimin e Politikave Migratore (ICMPD).

Parimet drejtuese mbi të cilat është hartuar Strategjia:

Strategjia dhe Plani i Veprimit kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore është ndërtuar mbi parimet e mëposhtme, të cilat përbëjnë kornizën konceptuale të masave anti-trafikim:

- Përgjegjësia kryesore e Qeverisë,
- Pjesëmarrja e shoqërisë civile,
- Trajtim i viktimave bazuar në të drejtat e njeriut;

- Bashkëndim ndër-disiplinor dhe masa ndër-sektoriale në nivel qeveritar, dhe mes Qeverisë, ON-ve dhe OJF-ve;
- Vlerësim sistematik dhe qëndrueshmëri.

Kapitulli I – Analizë e përgjithshme e situatës

Konteksti

Veçanërisht falë përpjekjeve të harmonizuara të të gjithë aktorëve shtetërorë dhe jo-shtetërorë, si dhe të organizatave ndërkombëtare dhe donatorëve, situata në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore përgjithësisht është përmirësuar, ose të paktën është stabilizuar, me numrat e viktimave të trafikimit në rënie.

Shqipëria nuk është një vend transit apo destinacioni për viktimat e huaja, Shqipëria është kryesisht një vend origjine për trafikimin ndërkombëtar të femrave dhe fëmijëve; femrat trafikohen kryesisht për shfrytëzim prostitucioni dhe punë të detyruar, ndërsa fëmijët në pjesën më të madhe dërgohen për lypje dhe punë të detyruar. Vendet kryesore të destinacionit për gratë dhe vajzat shqiptare janë Greqia, Italia, Maqedonia, Kosova si dhe vendet e BE-së (gjithashtu si rajon final i destinacionit). Rekrutimi në të shumtën e rasteve kryhet përmes mashtrimit, nga persona të njohur me viktimën, të cilët bëjnë oferta të rreme pune ose premtime për martesë. Fëmijët vazhdojnë të trafikohen, kryesisht në Greqi, nga prindërit e tyre ose pjesëtarë të familjes.

Një rritje shqetësuese është vërejtur në trafikimin e brendshëm të grave dhe fëmijëve, kryesisht për prostitucion dhe shfrytëzim të krahut të punës, veçanërisht në zonat e reja joformale të qendrave urbane. Shtrirja e plotë e problemit mbetet ende për t'u vlerësuar, dhe mekanizmat për identifikimin, referimin dhe raportimin e rasteve të tilla po fillojnë të ngrihen. E njëjtja gjë vlen edhe për trafikimin për shfrytëzim të krahut të punës nga Shqipëria, për në Shqipëri dhe brenda Shqipërisë.

Bashkësitë rome dhe egjiptian-ballkanase mbeten grupet më në rrezik trafikimi, ashtu si edhe zonat e reja joformale, bashkësitë e tjera të izoluar, gratë dhe fëmijët në zonat e varfra dhe rurale të vendit dhe personat pa një rrjetë sigurie familjare. Këto grupe dhe persona të prekshëm janë një pre e lehtë për trafikantët dhe për ata që kanë qëllim shfrytëzimin e të tjerëve.

Gjatë viteve të fundit përfshirja e grupeve kriminale të organizuara dhe e rrjeteve të trafikimit duket të ketë pësuar një rënie, kryesisht si pasojë e përfshirjes së tyre në forma të tjera më fitimprurëse të tregtisë së paligjshme (drogë dhe armë), Sic është përmendur dhe më lart rekrutuesit janë anëtarë të familjes (të viktimave të mitura) ose të njohur të viktimave. Manipulimi psikologjik dhe shantazhi duken se janë metodat mbizotëruese të përdorura nga trafikantët, ndryshe nga dhuna fizike e përdorur kryesisht në të shkuarën.

Kjo Strategji dhe Plan Veprimi përmbajnë politika dhe masa për të adresuar këto fenomene të reja.

Arritjet aktuale

Qeveria e Shqipërisë ka identifikuar problemin dhe e ka bërë një përparësi kryesore. Angazhimi i madh i të gjithë aktorëve të përfshirë ka rezultuar në një përparim të prekshëm drejt çrrënjësjes së trafikimit të qenieve njerëzore. Gjatë periudhës 2005 – 2007 janë shënuar arritje mjaft të rëndësishme, përfshirë¹:

- Ngritja e Njesisë Anti-trafikim në Ministrinë e Brendshme² në varësi të Koordinatorit Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore/Zëvendës Ministri i Brendshëm, i ngarkuar me monitorimin dhe bashkërendimin e veprimtarive të të gjithë aktorëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë të përfshirë, mes të tjerave, në zbatimin e Strategjisë Kombëtare kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe të Planit të Veprimit 2005 – 2007. Gjithashtu, Njësia Anti-trafikim ka hartuar raporte periodike për situatën e trafikimit në Shqipëri, përfshirë Raportin e Vlerësimit për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2005 – 2007, dhe ka vepruar si Sekretariati Teknik i Komitetit Shtetëror (ndër-ministror) për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore. Njësia ka qenë nismëtari për materializimin e veprimtarive të mëposhtme.
- Ndryshimet e kuadrit ligjor (Kodi Penal) përfshinë kriminalizimin e kontrabandimit të personave, në përputhje me protokollin e Kombeve të Bashkuara, si dhe një sërë ndryshimesh ligjore në lidhje me trafikimin e fëmijëve.
- Nënshkrimi dhe ratifikimi i 14 marrëveshjeve dhe konventave për bashkëpunim ndërkombëtar dhe rajonal në fushat e drejtësisë, bashkëpunimit policor, asistencës ligjore kundër trafikimit dhe krimit të organizuar, mbrojtjes së viktimave të mitura të trafikimit, ri-pranimit të personave, trafikimit të paligjshëm të lëndëve narkotike, përgjegjësisë prindërore dhe aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve; si dhe ratifikimi i marrëveshjeve dypalëshe me Greqinë (ende për t'u ratifikuar nga Greqia) për bashkëpunim në identifikimin, mbrojtjen, rehabilitimin dhe kthimin e sigurt të fëmijëve shqiptarë nga Greqia³.
- Ngritja e një baze të dhënash mbi viktimat e trafikimit, e cila do të bëhet plotësisht operative në vitin 2008.
- Direktiva dhe udhëzime për të përmirësuar identifikimin e personave të trafikuar në kufi, dhe sensibilizimi i një game të gjerë aktorësh që mund të hyjnë në kontakt me personat e trafikuar.
- Përfundimi i “Marrëveshjes së bashkëpunimit për ngritjen e një Mekanizmi Kombëtar Referimi për përmirësimin e identifikimit dhe asistencës ndaj viktimave të trafikimit” (MKR), më 18 korrik, 2005.
- Vendosja e “Autoritetit Përgjegjës”, përmes urdhrit të përbashkët mes Ministrisë së Brendshme, MPCSSH-së dhe MPJ-së, datë 19.05.2006, përgjegjës për bashkërendimin, përpunimin dhe raportimin e veprimeve të nevojshme të të gjitha strukturave të përfshira në marrëveshjen e MKR-së, si dhe për monitorimin e zbatimit të saj.

¹ Për përmbajtjen e plotë shih Raportin e Vlerësimit për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2005 – 2007, Republika e Shqipërisë, Ministria e Brendshme, Tiranë, janar 2008.

² Urdhër Nr. 203 i Kryeministrit “Për funksionimin e Njesisë Anti-trafikim”, datë 19.12.2005.

³ Shih Strategjinë kundër Trafikimit të Fëmijëve

- Mbajtja e qendrave të pritjes dhe strehëzave për asistencë dhe mbrojtje ndaj viktimave me rritje të mbështetjes me fonde shtetërore.
- Zhvillimi i standardeve për shërbimet e përkujdesjes shoqërore për personat e trafikuar ose personat në rrezik trafikimi në zonat e banuara.
- Zhvillimi i mekanizmave ndërkombëtarë të referimit dhe të menaxhimit të çështjeve për të siguruar identifikimin e viktimës, asistencë dhe mbrojtje gjithashtu përtej kufijve shtetërorë, si dhe një sërë takimesh ndërkufitare dypalëshe për të përforcuar bashkëpunimin në praktikë.
- Organizimi i fushatave të sensibilizimit me synim grupet në rrezik.
- Masa për të zbatuar arsimin e detyrueshëm për të rritur pjesëmarrjen e grupeve të izoluara në sistemin arsimor formal, dhe trajnime për aftësi profesionale/jetësore për të larguarit nga shkollat, fushata sensibilizimi për fëmijët dhe të rinjtë dhe përfshirja e këtyre fushatave në programet mësimore shkollore.
- Linja telefonike kombëtare falas për ndihmë (0800 12 12), që operohet nga Ministria e Brendshme nga nëntori i vitit 2007.
- Krijimi i Komiteteve Rajonale kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, përmes Urdhrit nr. 139 të Kryeministrit, datë 19.06.2006. Komitetet kanë për detyrë kryerjen e vlerësimeve periodike për situatën rajonale dhe nevojat specifike, evidentimin e përparësive për veprim në nivel rajonal; identifikimin e grupeve në rrezik dhe ngritjen e rrjeteve të mbrojtjes në nivel vendor;
- Modernizimi i Shërbimit të Gjendjes Civile.
- Organizimi i Javës Evropiane kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore në tetor 2007, me moton: *“Trafikimi i Qenieve Njerëzore është Skllavëri! Ne nuk mund ta pranojmë! Ne luftojmë për një shoqëri të lirë dhe të sigurt”*.
- Lufta kundër korrupsionit, që rezulton në ndëshkime administrative dhe penale për zyrtarët që bashkëpunojnë në trafikimin e qenieve njerëzore.
- Rritje e ndjekjeve penale dhe e gjyqimeve në vitet e fundit. ⁴

Sfidat që mbeten për t’u kapërcyer

Pavarësisht këtyre përpjekjeve, ende mbetet një numër sfidash që duhen trajtuar në Strategjinë dhe Planin e Veprimit 2008 – 2010, si vijon:

- Zbatimi i pjesshëm i kuadrit ligjor ekzistues kundër trafikimit, p.sh. dallimi i pamjaftueshëm mes prostitucionit dhe trafikimit të qenieve njerëzore për shfrytëzim seksual, dhe mes trafikimit për shfrytëzim të krahut të punës dhe kontrabandimit dhe punës së paligjshme.
- Komitetet Rajonale Anti-Trafikim nuk janë plotësisht funksionale si pasojë, mes të tjerash, e mungesës së qartësisë për sa u përket roleve dhe përgjegjësive dhe ndarjes së detyrave mes niveleve kombëtare, rajonale dhe vendore, dhe si pasojë e numrit të pamjaftueshëm të personelit.
- Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Anti-trafikimin/Njësia Anti-trafik nuk ka burimet e mjaftueshme njerëzore për t’u bërë ballë detyrave.

⁴ Për statistika referoju Raportit të Vlerësimit

- Një bashkërendim ndër-ministor dhe përkatësi institucionale më e mirë nga çdo aktor për zbatimin e detyrave përkatëse në Planin Kombëtar të Veprimit; të rritet roli i Pikave të Kontaktit të posaçme.
- Mekanizmi Kombëtar i Referimit (MKR) ende nuk është plotësisht operativ, si pasojë edhe e faktit që Autoriteti Përgjegjës nuk është shumë operativ, megjithëse janë mbajtur takime dhe çështjet janë trajtuar dhe u është gjetur zgjidhje.
- Përmirësimi i procesit dhe instrumenteve të identifikimit të viktimave të mundshme të trafikimit, sidomos të personave të trafikuar së brendshmi dhe personave të trafikuar për shfrytëzim të krahut të punës.
- Të dhëna zyrtare të pamjaftueshme dhe vlerësime të pamjaftueshme të situatës, statistika të varfra (mungesë e të dhënave zyrtare dhe statistikave të koordinuara dhe të besueshme, mungesë e përkufizimeve të paracaktuara të punës).
- Mungesa e një sistemi zyrtar funksional për monitorimin sistematik të zbatimit të masave të parashikuara në PKV, dhe raportim i pamjaftueshëm nga ana e aktorëve (vonesa në raportim dhe cilësi e dobët e raporteve).
- I duhet vënë më shumë theksi parandalimit dhe bashkëngjites së përpjekjeve anti-trafikim në asistencën sociale dhe punën mbrojtëse, masa kundër dhunës në familje, si dhe përpjekjeve të përgjithshme për zhvillimin e vendit.
- Situata e grupeve të pakicës, si rome dhe egjiptiane dhe grupeve të tjera në nevojë ka nevojë për një vëmendje më të madhe edhe në aspektin e parandalimit të trafikimit njerëzor.
- Sigurimi i financimit të qëndrueshëm për strukturat dhe shërbimet anti-trafikim, duke pasur parasysh pakësimin e donacioneve të jashtme në vitet në vijim.

Kapitulli II – Vizioni, përparësitë dhe synimet

Politikat, instrumentet dhe masat mbështetëse janë të vendosura dhe të arritshme nga burrat, gratë dhe fëmijët që rrezikojnë trafikimin, ose që kanë vuajtur nga trafikimi njerëzor, të cilat i mundësojnë ata që të integrohen plotësisht në shoqëri dhe të jetojnë sipas vullnetit të tyre, dhe që krijojnë një gjendje shprese dhe përkatësie për të gjithë personat që jetojnë në Shqipëri, duke ulur kështu trafikimin e qenieve njerëzore. Kjo Strategji synon ndërtimin e një shoqërie pa kërcënime nga krimi i organizuar, në paqe dhe në përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë së jetës së qytetarëve, duke dhënë në këtë mënyrë imazhin e një vendi të qetë dhe me standarde të larta sigurie.

Për ta arritur këtë vizion do të jetë e nevojshme të arrihen përparësitë strategjike të mëposhtme:

Përparësia kryesore është institucionalizimi i mëtejshëm i një reagimi shumë-disiplinor, të qëndrueshëm dhe të bashkërenduar kundër trafikimit, në mënyrë që të punohet drejt reduktimit progresiv dhe eliminimit të trafikimit të qenieve njerëzore dhe të bëjmë të mundur fuqizimin e të gjithë personave që jetojnë në Shqipëri.

Gjatë periudhës që mbulon kjo Strategji (2008-2010) do të forcohet përgjegjësia kryesore e Qeverisë. Masat anti-trafikim do t'u bashkëngjiten politikave dhe programeve të aktorëve shtetërorë, dhe në veçanti asistencës sociale dhe sistemeve të mbrojtjes. Duke qenë se

financimi nga donatorët gradualisht po dobësohet, Qeveria e Shqipërisë do të sigurojë qëndrueshmëri duke siguruar shumicën e financimit të nevojshëm. Duke bërë kështu, Qeveria vepron në bazë të përparësisë së shpallur në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, dhe vazhdon rrugën e saj drejt integritit në Bashkimin Evropian; gjithashtu kontribuon në përmbushjen e standardeve të pritura për anëtarësim në NATO.

Parandalimit do t'i jepet më shumë rëndësi në reagimin kundër trafikimit si politika e parapëlqyer, si në aspektin njerëzor ashtu dhe në aspektin ekonomik. Theksi bie mbi masat parandaluese në nivel vendor dhe rajonal, përmes forcimit të sistemeve gjithëpërfshirëse të mbrojtjes dhe asistencës në përgjithësi, dhe për bashkësitë dhe individët në rrezik në veçanti; masat do të synojnë sidomos bashkësitë në nevojë të pakicës, si dhe bashkësitë e reja joformale në qendrat urbane, si dhe gratë dhe të rinjtë e prekshëm. Do të ofrohen alternativa jo-shfrytëzuese kundrejt trafikimit njerëzor, përmes asistencës sociale dhe opsioneve të jetesës, si dhe përmes mundësisë për migracion të ligjshëm dhe të sigurt; veç këtyre sensibilizimi dhe informimi i publikut do të mbetet thelbësor.

Vëmendje e veçantë i duhet kushtuar identifikimit të hershëm të të gjithë personave të trafikuar (përfshirë personat e trafikuar së brendshmi dhe personat e trafikuar për shfrytëzim pune) dhe referimit të tyre të ndihma dhe shërbimet. Kjo do të sigurohet me anë të funksionimit të plotë të Mekanizmit Kombëtar të Referimit dhe mekanizmave të referimit të çështjeve në nivel vendor.

Lufta kundër trafikimit të fëmijëve dhe asistencë ndaj dhe mbrojtja e viktimave fëmijë të trafikimit mbetet një shqetësim kyç i Qeverisë së Shqipërisë, i cili theksohet nga fakti se, krahas masave të parashikuara në këtë strategji, kësaj strategjie i bashkëngjiten një strategji më vete dhe një plan veprimi kundër trafikimit të fëmijëve. Ajo përbën një pjesë të pandashme të kësaj strategjie dhe thekson qasjen specifike që nevojitet për trajtimin e trafikimit të fëmijëve dhe për marrëdhëniet me të miturit.

Kapitulli III – Politikat që duhen ndërmarrë

Për të arritur vizionin dhe përparësitë e përvijuara më sipër duhen ndërmarrë politikat e mëposhtme:

1. Përmirësimi i bashkërendimit të të gjitha masave kundër trafikimit dhe bashkëpunim efektiv mes të gjithë aktorëve në fushën kundër trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri, me anë të institucionalizimit të një kuadri kombëtar funksional për bashkëpunim dhe bashkërendim kundër trafikimit.
2. Forcimi i bazës së njohjes dhe menaxhimit të informacionit mbi trafikimin e qenieve njerëzore, duke rezultuar në të dhëna statistikore të unifikuara, si dhe përmirësimi i vazhdueshëm i reagimit kundër trafikimit duke ngritur mekanizma të forta për monitorim, vlerësim dhe rishikim të rregullt.
3. Sigurimi i funksionimit të plotë të “Mekanizmit Kombëtar të Referimit” si një mekanizëm gjithëpërfshirës bashkërendimi dhe referimi kombëtar, rajonal dhe

vendor për të siguruar identifikim, asistencë dhe kthim/(ri)-integrim të personave të trafikuar dhe individëve në rrezik.

4. Sigurimi i identifikimit të hershëm të të gjithë personave të trafikuar dhe për të gjitha format e shfrytëzimit, dhe e të drejtës së tyre për asistencë dhe mbrojtje të përshtatshme dhe me cilësi të lartë, rehabilitim afatgjatë dhe përfshirje shoqërore; trajtim i bazuar në të drejtat e njeriut, etik dhe i ndjeshëm për të gjithë personat e trafikuar nga të gjithë aktorët, si dhe e drejta e tyre për korrigjim dhe kompensim ligjor;
5. Rritja e sensibilizimit publik për trafikimin njerëzor dhe alternativat jo-shfrytëzuese si dhe reduktimi i ekspozimit ndaj trafikimit dhe shfrytëzimit duke përmirësuar përfshirjen shoqërore dhe duke ofruar alternativa të tjera profesionale dhe jo-shfrytëzuese dhe duke krijuar mjedise mundësie në përgjithësi, dhe për grupe vulnerabël në veçanti ; dhe krijimi i hallkave me proceset dhe strategjitë në vazhdim të reformës kombëtare.⁵
6. Rritja numrit të ndjekjeve penale dhe gjykimeve të suksesshme, dhe sigurimi i një trajtimi të drejtë dhe të ndjeshëm ndaj viktimave të trafikimit gjatë procedimeve penale, përfshirë mbrojtjen ndaj dëshmitarit.
7. Parandalimi i trafikimit të fëmijëve, dhe mbrojtja, ndihma dhe ri-integrimi i viktimave fëmijë të trafikuar.

Këto synime strategjike dhe objektiva specifike janë përpunuar dhe zbërthyer më tej në objektiva specifike dhe veprimtari të nevojshme në Planin e Veprimit të bashkëngjitur.

Përkufizimet ligjore ku mbështetet Strategjia kundër Trafikimit të Fëmijëve:

Për qëllimin e kësaj Strategjie:

Trafikim i qenieve njerëzore nënkupton rekrutimin, transportimin, transferimin, strehimin ose pranimin e personave me anë të kanosjes ose përdorimit të forcës ose formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, hilesë, apo të përfitimit nga pushteti ose pozitës së dobët ose të dhënies apo marrjes së pagesave apo avantazheve për të arritur pëlqimin e një personi që ka kontroll mbi një person tjetër për qëllime shfrytëzimi. Shfrytëzimi nënkupton, së paku, shfrytëzimin e të tjerëve për prostitucion apo forma të tjera shfrytëzimi seksual, punë apo shërbime të detyruara, skllavëri ose praktika të ngjashme me skllavërinë, robëri ose heqje të organeve; [Neni 3 (a)].⁶

5 Përfshirë Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, si dhe strategjitë për Zhvillim Rajonal, Barazi Gjinore dhe Dhunën në Familje, Migracion, dhe Menaxhim të Integruar të Kufijve, Uljen e Varfërisë, Shërbimin Social, Punësimin, etj.

⁶ Protokollin e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin, Eliminimin dhe Ndëshkimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore, veçanërisht Grave dhe Fëmijëve, që plotëson Konventën e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (2000).

Rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose pranimi i një fëmije për qëllim shfrytëzimi do të konsiderohet “trafikimin i qenieve njerëzore” edhe nëse nuk përfshin asnjë nga mjetet e parashikuara në nën-paragrafin IV (a) të këtij neni; [Neni 3 (c)].

Fëmijë nënkupton çdo person nën moshën 18 vjeç; [Neni 3 (d)].

Viktimë e trafikimit i referohet çdo personi i cili cilësohet si viktimë në përputhje me Nenin 3 të sipërpërmendur të Protokollit të OKB-së për Trafikimin.

Termi **person i trafikuar** përdoret në mënyrë të këmbyeshme me termin **viktimë e trafikimit**, duke iu referuar kështu të gjithë personave që përmbushin kriteret e Protokollit të OKB-së për Trafikimin.

Kapitulli IV – Buxheti

Duke miratuar Strategjinë dhe Planin e saj të Veprimit 2008-2010, të gjithë aktorët përgjegjës kanë marrë angazhimin për të siguruar implementimin e detyrave që përmban ky dokument dhe që janë nën përgjegjësinë e tyre respektive, duke përfshirë sigurimin e burimeve të kërkuara nëpërmjet parashikimit të qartë të fondeve në Planin Buxhetor Afatmesëm (PBA) për të gjitha aktivitetet zbatuese të kësaj Strategjie.

Agjensitë kryesore kanë marrë përgjegjësinë e zbatimit të aktiviteteve të tyre respektive, duke përfshirë dhe buxhetimin për çdo aktivitet. Nëse një aktivitet parashikon përgjegjësi të përbashkëta të dy ose më shumë aktorëve, detyrimi i përbashkët buxhetor është i përcaktuar në Planin e Veprimit.

Ndërkohë që Plani i Veprimit përmban vetëm burimin buxhetor, por jo koston e saktë për çdo masë, është parashikuar vendosja e një buxheti të plotë dhe raporte të shpenzimeve nga 2009 e më tej. (Shih Kuadri Operacional: Koordinimi)

Kapitulli V – Monitorimi dhe analiza e vlerësimit

Përgjegjësia për monitorimin dhe zbatimin e kësaj Strategjie Kombëtare dhe Plani Veprimi për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Strategjisë Kombëtare kundër Trafikimit të Fëmijëve i takon Komitetit Shtetëror për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, i cili kryesohet nga Ministri i Brendshëm. Komiteti Shtetëror do të asistohet në këtë detyrë nga Task-Forca Kombëtare mbi Trafikimin e Qenieve Njerëzore, Koordinatori Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Zyra e Koordinatorit Kombëtar. Treguesit kryesorë kyçë për monitorimin e strategjisë dhe Planit të Veprimit jepen në Planin e Veprimit. Një plan sistematik për monitorimin, vlerësimin dhe rishikimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit do të përpunohet nën përgjegjësinë e Zyrës së Koordinatorit Kombëtar.

Çdo ministri apo institucion që ka detyrime në kuadrin e kësaj strategjie do të raportojë mbi mbarëvajtjen e punës për zbatimin e Planit të Veprimit kundër Trafikimit tek Koordinatori

Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Personave dhe Komiteti Shtetëror për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, çdo tre muaj, duke filluar nga data e miratimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit nga Këshilli i Ministrave.

Ky Komitet do ta informojë sistematikisht Kryeministrin mbi zbatimin e kësaj Strategjie dhe Plani Veprimi.

Aneksi I: Një pasqyrë e kuadrit kombëtar për bashkëpunimin dhe koordinimin ndërmjet aktorëve anti-trafik

Në mënyrë që të luftohet efektivisht trafikimi i qenieve njerëzore dhe të ushqejmë fuqizim, është thelbësore të institucionalizojmë një kuadër kombëtar funksional për të siguruar një koordinim dhe bashkëpunim efektiv ndërmjet aktorëve të përfshirë, me qëllim parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore, mbrojtjen dhe ndihmën ndaj personave të trafikuar dhe ndjekjen penale dhe dënimin e trafikantëve.

Kuadri i parashikuar përmban:

- i. Një mekanizëm për koordinim, përcaktimin e politikave, planifikim dhe analizë e vazhdueshme e situatës lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore, monitorimi, vlerësimi dhe rishikimi i masave antitrafik (strategji dhe plan-veprimi);
- ii. Mekanizëm Kombëtar Referimi, si një sistem për menaxhimin e rasteve dhe sigurimin e identifikimit, mbrojtjes dhe dhënies së ndihmës personave vulnerabël dhe të trafikuar.

Për këtë qëllim, do të ngrihet një **grup ad-hoc ndërdisiplinor Ekspertësh** (anëtarë të agjensive shtetërore dhe joshtetërore nga Grupi i Punës së MKR, Autoriteti Përgjegjës, Komitetet Antitrafik, aktorë të tjerë vendas dhe partnerë ndërkombëtar). Grupi ad-hoc i Ekspertëve do të përfundojë punën në fund të vitit 2008 dhe do të hartojë një Plan Veprimi të detajuar që përfshin një ndarje të qartë të detyrave, detyrat respektive për të gjithë aktorët, procedura standarde operative mbi bashkëpunimin dhe koordinimin ndërmjet gjithë aktorëve të përfshirë dhe një plan zbatimi me afate. Pas miratimit nga Komiteti Shtetëror, Plani i Veprimit do të zbatohet (duke përfshirë rishikimin e mandateve, termat e referencës, PSO-të, trajnime/seminare me të gjithë aktorët mbi kuadrin e ri të bashkëpunimit dhe detyrat e tyre respektive). Detaje mbi kuadrin e parashikuar koordinues dhe rolet e secilit prej aktorëve të përfshirë janë dhënë si më poshtë vijon.:

Aktivitete të tjera që kanë për qëllim të institucionalizojnë një kuadër funksional antitrafik dhe një përgjigje efektive:

- Forcimi i Zyrës së Koordinatorit Kombëtar , për të siguruar zbatimin e aktiviteteve të parashikuara në Plan Veprimi duke rritur resurset njerëzore dhe financiare;
- Krijimi i një Zyre të veçantë për Autoritetin Përgjegjës brenda vitit 2010; në periudhën e ndërmjetme vendos një zyrë të vogël/me staf prej 3 persona, pranë ZKKA-së.
- Forcimi i Komiteteve Rajonale Antitrafik (shtrirja e punës dhe termat e referencës/qartësim-rishikim i Urdhrit të Kryeministrit, caktimi i një koordinatori rajonal me kohë të plotë dhe zgjerim i anëtarësisë për përfshirjen nën-prefektët, drejtoritë e kufirit dhe migracionit, këshillat e qarkut, OJF-të).
- Krijimi i Task-forcës Kombëtare mbi Trafikimin e Qenieve Njerëzore (zëvendëson grupin aktual të kontaktit) i ngarkuar me hartimin, zbatimin dhe vlerësim periodik i masave antitrafik, nën përgjegjësinë e Komitetit Shtetëror dhe Koordinatorit Kombëtar, dhe përfshirja e të gjithë aktorëve shtetëror dhe joshtetëror antitrafik.

Struktura Kombëtare Koordinuese për parandalimin, dhënien e ndihmës dhe mbrojtjen – ndarje e detyrave (do të qartësohet nga Grupi ad-hoc i ekspertëve):

Niveli Kombëtar:

Koordinatori Kombëtar Anti-trafik

Detyrat: Përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e një përgjigje gjithëpërfshirëse antitrafik, duke përfshirë monitorim, vlerësim dhe rishikim të vazhdueshëm; koordinim informacioni dhe menaxhim dhe shkëmbim të dhënash; koordinim i të gjithë aktiviteteve antitrafik në vend; mobilizim i buxhetit dhe resurseve; pikë ndërlidhëse me të gjithë partnerët/organizatat/donatorët vendas dhe ndërkombëtar dhe mbajtja e takimeve të rregullta; përgjegjës për raportim të rregullt qeverisë, Komitetit Shtetëror dhe Parlamentit, dhe sigurimi i mbështetjes dhe angazhimit politik; kryeson Task-Forcën Kombëtar dhe siguron takime të rregullta.

ZKKA:

Detyrat: Ofrim i mbështetjes teknike për Komitetin Shtetëror për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Koordinatorit Kombëtar Antitrafik, si dhe Task-forcës Kombëtare për anti-trafikimin e qenieve njerëzore dhe dhënia e ndihmës për implementimin e të gjithë aktiviteteve; koordinim i të gjithë aktiviteteve, menaxhim, shkëmbim, monitorim, raportim i të dhënave dhe informacionit.

Komiteti Shtetëror për Luftën kundër Trafikimin e Qenieve Njerëzore

Detyrat: Përgjegjësi për hartimin dhe zbatimin e masave anti-trafik, dhe monitorim, vlerësim, dhe rishikim i vazhdueshëm, me asistencën e Koordinatorit Kombëtar, ZKKA dhe Task-forca Kombëtare mbi antitrafikimin.

Task-forca Kombëtare mbi Antitrafikimin

Detyrat: Hartim, zbatim dhe vlerësim periodik i masave antitrafik (strategjia dhe plan-veprimi), nën përgjegjësinë e Komitetit Shtetëror të Luftës kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Koordinatorit Kombëtar Anti-trafik dhe mbështetjes teknike nga ZKKA; duke përfshirë: vlerësime periodike të situatës në vend (të mbështetura në vlerësime rajonale), standardet kombëtare, përcaktimi i politikave dhe procedurave, dhe monitorimi i zbatimit, vendosja e prioriteteve kombëtare dhe hartim i programit, buxhetimi; takime të shpeshta (të paktën çdo tre-muaj) .

Anëtarë: Të gjithë aktorët antitrafik në nivel teknik, duke përfshirë përfaqësues të autoriteteve shtetërore, Prokurorisë së Përgjithshme, Komiteteve Rajonale Antitrafik, OJF, Institute Trajnimi, aktorë të tjerë të përfshirë.

Grupi i Punës për Mekanizmin Kombëtar të Referimit

Detyrat: Monitorim i zbatimit të Marrëveshjes së MKR me mbështetjen teknike të Autoritetit Përgjegjës, përcaktimi dhe rishikim i rregullt i standardeve kombëtare dhe procedurave operative (PSO-ve) për trajtimin e personave të trafikuar gjatë procesit të referimit dhe monitorimi i zbatimit të tyre, zgjidhjen e rasteve jo të zakonshme/raste referimi të ndërlikuara (veçanërisht për raste ndër-rajonale dhe raste ndërkombëtare)

Anëtarë: Të gjithë nënshkruesit e Marrëveshjes së MKR, përfshirë MB, PSH, MPCSSHB, MPJ, ZKKA, OJF-të nënshkruese, PP, KRAT-et)

Autoriteti Përgjegjës:

Detyrat: Monitorim i zbatimit të Marrëveshjes së MKR. Menaxhim i të dhënave (duke përfshirë bazën e të dhënave për viktimat e trafikimit) dhe raportim. Mbajtjen e mbledhjeve të rregullta të Grupit të Punës së MKR dhe dhënien e mbështetjes teknike grupit. Dhënie e ndihmës dhe ndërhyrje në raste jo të zakonshme/shqetësuese kur është e nevojshme (veçanërisht për raste ndër-rajonale dhe raste ndërkombëtare).

Anëtarët: Të gjithë nënshkruesit e Marrëveshjes së MKR-së (MB, MPCSSHB, MPJ, OJF-të nënshkruese etj.)

Aktorët në nivel rajonal:

Komitetet Rajonale Antitrafik, Tavinat Teknike, Sekretariati Teknik

Detyrat: Planifikim dhe vlerësim i situatës dhe nevojave në nivel rajonal, vendosja e prioritetëve dhe hartimi i programeve në nivel rajonal; siguron zbatimin e standardeve kombëtare në nivel bashkie/komune duke kryer monitorime dhe kontrolle cilësie; siguron dhënien e shërbimeve për grupe/persona vulnerabël dhe të trafikuar në nivel lokal; ndihmon strukturat referuese në nivel bashkie dhe ndërhyrjen në raste jo të zakonshme/të ndërlidhura; pjesëmarrje në Task-forcën kombëtare për Antitrafikun, dhe në Grupin e Punës për MKR.

Anëtarë: Prefekti, Nën-Prefekti, Kryetar të Këshillit të Qarkut, Koordinatori Lokal i Komitetit Rajonal Antitrafik, Kryetari i Bashkisë më të madhe në qark, Zyra Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, Zyra Rajonale e Punësimit, Drejtoria e Policisë së Qarkut përfshirë Policinë Antitrafik, Drejtoritë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit, Drejtori Rajonale të Shërbimit Informativ Shtetëror, Drejtoria Rajonale Arsimore, Drejtoria Rajonale e Shëndetit Publik, Zyrat e Mbrojtjes dhe Asistencës Sociale, përfshirë dhe Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve në bashki dhe komuna, Prokuroritë e Rretheve, si dhe OJF-të.

Niveli në Bashki/Komuna:

Zyrat e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit shoqëror/Njësitë e Mbrojtjes

Detyrat: Siguron identifikimin, referimin dhe asistencën e personave në risk dhe personave të trafikuar, në formë sa më të përshtatshme; menaxhim i rasteve dhe dokumentim rasti; kryeson grupin lokal multi-disiplinar/mekanizma referues lokal dhe ndërlihdës me të gjithë anëtarët, siguron hartimin e PSO-ve për referim, mban takime të rregullta dhe ad-hoc; ndërlihdës me Njësi të tjera të Mbrojtjes dhe Asistencës Sociale, dhe me Komitetet Rajonale dhe Autoritetin Përgjegjës; raporton rregullisht tek Autoriteti Përgjegjës dhe Komitetet Rajonale/ZKKA, referon probleme dhe raste jo të zakonshme në nivelin përkatës (KRAT dhe/ose AP), përfaqëson bashkinë/komunën në Komitetin Rajonal Antitrafik.

Anëtarë: Pika(t) e kontaktit për mbrojtjen e fëmijëve, barazinë gjinore, dhunën në familje, trafikimin e qenieve njerëzore; si dhe të paktën një punonjës social (punonjës i caktuar për ndjekjen e rastit) në çdo bashki/komunë

Grup ndër-disiplinor/Mekanizëm Referues Lokal

Detyra: Monitoron situatën dhe identifikon grupet në risk dhe personat e trafikuar, koordinon masat parandaluese dhe mbrojtëse, dhënie e ndihmës dhe mbështetje, jep shërbime brenda kompetencave, takime të rregullta, dhe sipas nevojës, diskutim të rasteve problematike, hartim dhe rishikim të PSO-ve

Anëtarë: Zyrat e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit shoqëror, policia, prokurorë, punonjës të shëndetit publik, punonjës social, mësues, zyrat e punësimit, inspektorët e punës, OJF-të, etj.

Aneksi II - Kuadri ligjor shqiptar ku mbështetet Strategjia:

Legjislacioni parësor

- Ligji nr. 7895, datë 27.01.1995 “Për Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji nr. 8733, datë 24.01.2001 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Penal”;
- Ligji nr. 8920, datë 11.7.2002, “Mbi ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar dhe dy protokollat e saj shtesë”;
- Ligji nr. 9188, 12.02.2004, shtesa në Kodin Penal futi veprën kriminale të trafikimit të femrave dhe trafikimit të të miturve. Ligji fut përkufizime të reja për veprat e trafikimit në përputhje me Protokollin e Palermos për Trafikimin;
- Ligji nr. 9187, datë 12.02.2004 “Për disa ndryshime në Kodin e procedurës Penale në lidhje me përdorimin e mjeteve të posaçme hetuese si : përgjimet, agjentët e infiltruar, etj., përdorur për hetimin e krimit të organizuar përfshirë trafikimin e personave;
- Ligji nr. 9205, datë 15.03.2004 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”;
- Ligji nr. 9284, datë 30.9.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”, i cili parashikon sanksione penale, si dhe konfiskimin e aseteve të kriminelëve;
- Ligji nr. 9355, datë 10. 03. 2005 “Për Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore”. Me këtë ligj, Bashkitë kanë autoritetin të financojnë shërbime të ofruara nga OJF me të ardhurat e buxhetit qendror;
- Ligji nr. 9509, datë 03.04.2006 “Për Moratoriumin e mjeteve të lundrimit”;
- Ligji nr. 9544, datë 29.05.2006 “Për ratifikimin e Marrëveshjes midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Greke, për Mbrojtjen dhe Asistencën për Fëmijët Viktima të Trafikimit”;
- Ligji nr. 9642, datë 20.11.2006 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për Veprim kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore”;
- Ligji nr. 9668, datë 18.12.06, “Për Migrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi”. Disa nene të këtij ligji lidhen me parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe lehtësimin e ri-integrimit në tregun e punësimit;
- Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”;
- Ligji nr. 9686, datë 26.02.2007 “Për disa ndryshime në nenin 298 të Kodit Penal” mbi Ndihmën për Kalimin e Paligjshëm të Kufirit”;
- Ligji nr. 9833, datë 22.11.2007 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin Opsional të Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve për përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura”;
- Ligji nr. 9834, datë 22.11.2007 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin Opsional të Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve për shitjen e fëmijëve, prostitucionin e fëmijëve dhe pornografinë e fëmijëve”;
- Ligji nr. 9749, datë 04. 06. 2007 “Për Policinë e Shtetit”
- Ligji nr. 9859, datë 21.01.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Penal” ku nenet e shtuara janë neni 124/b, ”Keqtrajtimi i fëmijëve” që, midis të tjerave, kriminalizon fenomenin e shfrytëzimit të fëmijëve për punë të detyruar, lypje dhe shërbime të tjera të detyruara; paragrafi që u shtua në nenin 117 “Pornografia” në lidhje me pornografinë e të miturve, si dhe neni i shtuar 128/b “Trafikimi i

fëmijëve”, i cili kriminalizon me ligj jo vetëm rekrutimin, fshehjen, marrjen e fëmijëve, por edhe shitjen e tyre;

Aktet nënligjore:

- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 171, datë 11.02.2005 “Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare kundër Trafikimit të Fëmijëve dhe Mbrojtjes së Fëmijëve Viktima të Trafikimit, dhe Shtojca e Vendimit Nr. 8, datë 5.01.2002 të Këshillit të Ministrave, “Për Krijimin e Komitetit Shtetëror të Luftës kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 564 datë 12.08.2005, “Për Liçensimin e Ofruesve të Shërbimeve të përkujdesjes shoqërore”;
- Urdhri i Këshillit të Ministrave Nr. 25, datë 22.2.2005 “Për Miratimin e Planit të Veprimit për periudhën 2005-2007 në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Luftës kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore”;
- Marrëveshja e Bashkëpunimit, datë 18.07.2005 për Krijimin e një Mekanizmi Kombëtar Referimi për Identifikimin dhe Asistencën e Viktimave të Trafikimit midis Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale/Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Sociale Shtetërore, Qendrës Kombëtare të Pritjes për Viktimat e Trafikimit, Ministrisë së Rendit Publik / Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Ministrisë së Punëve të Jashtme / Drejtorisë Konsullore, organizatës joqeveritare “Vatra”, Vlorë, organizatës joqeveritare “Tjetër Vizion”, Elbasan dhe Organizatës Ndërkombëtare të Migrimit -Tiranë
- Urdhri i Këshillit të Ministrave Nr. 203, datë 19.12.2005 “Për funksionimin e Njësisë së Anti-Trafikimit”;
- Urdhri i Ministrit të Brendshëm Nr. 282 datë 13. 02. 2006 “Për instalimin e numrave të telefonit falas për denoncimin e korrupsionit dhe procedurat për realizimin e këtij aktiviteti në strukturat e Ministrisë së Brendshme për Drejtorinë e Kontrollit të Brendshëm”;
- Udhëzimi Nr. 6, datë 29.03.2006 i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës “Për regjistrimin në shkollë të fëmijëve romë që nuk kanë certifikatë lindjeje”;
- Urdhri i Kryeministrit Nr. 139, datë 19.06.2006 “Për krijimin e komiteteve rajonale të anti-trafikimit;
- Urdhri i Përbashkët Nr. 1192, datë 19.05.2006 i Ministrit të Brendshëm, Ministrit të Punëve të Jashtme dhe Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Mundësive të Barabarta për krijimin e Autoritetit Përgjegjës për Mekanizmin Kombëtar të Referimit;
- Marrëveshja e Bashkëpunimit të Ekipit të Përbashkët Teknik, 20 shtator 2006, “Për të drejtat e fëmijëve” midis përfaqësuesve të institucioneve shtetërore (Ministria e Brendshme, MPÇSSHB, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Avokati i Popullit), OJQ-ve dhe donatorëve të angazhuar për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 632 “Për punësimin e grave të papuna që kërkojnë punë”;
- Urdhri Nr. 645 datë 20.03.2006 “Për përparësitë e Programit të Promovimit të Punësimit për vitin 2006”;
- Urdhri Nr. 782, datë 04.04.2006 “Mbi tarifën e Sistemit të Formimit Profesional”;

- Sipas këtij urdhri, disa grupe njerëzish, përfshirë gra dhe vajza të trafikuar, përjashtohen nga pagimi i tarifave të regjistrimit për të ndjekur kurse trajnimi profesional për punëkërkes të regjistruar në zyrat e punës;
- Urdhri Nr. 714 datë 03.11.2006 i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë “Për procedurat e ndjekura për shtetasit shqiptarë dhe të huaj që kthehen nga vendet e tyre”. Ky urdhër përcakton detyrat e oficerëve të Policisë Kufitare dhe Migrimit dhe Sektorit të Luftës kundër Trafikimit të Paligjshëm në trajtimin e personave të kthyer, të identifikuar si viktimat e trafikimit dhe masat që duhen marrë;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 658, datë 17.10.2005, “Për Standartet e Shërbimeve Shoqërore”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 195, datë 11.04.2007, “Për miratimin e Standardeve të Shërbimeve të përkujdesit shoqëror, në qendrat rezidenciale, për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi”;
- Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë Nr. 871, datë 27.12.2007 “Për procedurat që duhen ndjekur për intervistimin e shtetasve të huaj dhe shqiptarë të kthyer nga vendet e tyre”;
- Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë Nr. 865, datë 26.12.2007 “Për hedhjen e të dhënave në një bazë të dhënash për viktimat e trafikimit”.

Fjalorth i Shkurtimeve

Fjalorth i shkurtimeve të përdorura në Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore:

KSHLKT	Komiteti Shtetëror i Luftës kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore
ZKKA	Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Anti-trafikimin
MB	Ministria e Brendshme
MPÇSSHB	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
MD	Ministria e Drejtësisë
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MKTRS	Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
MM	Ministria e Mbrojtjes
MF	Ministria e Financave
MBUMK	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit
SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror
AAPSK	Agjensia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara
PP	Prokuroria e Përgjithshme
KLD	Këshilli i Lartë i Drejtësisë
GJL	Gjykata e Lartë
GJKR	Gjykata e Krimeve të Rënda
SHISH	Shërbimi Informativ Shtetëror
PSH	Policia e Shtetit
AP	Autoriteti Përgjegjës
MKR	Mekanizmi Kombëtar i Referimit
MNR	Mekanizmi Ndër-nacional i Referimit
ICITAP	Programi Ndërkombëtar i Asistencës për Trajnim në Hetimet Penale
OJF	Organizatë jofitimprurëse
ON	Organizata Ndërkombëtare (UNICEF, KVKTNJ, ILO-IPEC, etj.)
KRAT	Komitetet Rajonale për Anti-trafikim
NjMF	Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës
KVKTNJ	Koalicioni i Veprimeve kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore
USAID	Agjensia e Shteteve të Bashkuara për Ndihmë Ndërkombëtare
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
UNICEF	Fondi Ndërkombëtar i Fëmijëve i Kombeve të Bashkuara
UNODC	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Krimin dhe Drogat
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
UNDP	Programi Ndërkombëtar për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
TdH	Terre des Hommes
SC	Save the Children
WV	World Vision
KKSAT	Koalicioni Kombëtar i Strehëzave Antitrafik
GKK	Grupet Këshillimore në Komunitet
OBK	Organizata me bazë në komunitet

BKTF
ATSH
APP
NPF

Koalicioni Bashkë kundër Trafikimit të Fëmijëve
Agjensia Telegrafike Shqiptare
Agjensitë Private të Punësimit
Ndihmë për Fëmijët

Kuadri Operacional

I. NDJEKJA dhe DREJTËSIA PENALE

Nr.	Veprimtaritë dhe nën-veprimtaritë	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
1.	SYNIMI STRATEGJIK: <i>Rritja e numrit të ndjekjeve penale dhe të dënimeve të suksesshme, si dhe e masave të duhura të dënimit për të gjitha format e trafikimit të qenieve njerëzore, nëpërmjet strukturave efikase dhe profesionale të zbatimit të ligjit që kryejnë hetime dhe procese gjyqësore të drejta, dhe që garantojnë të drejtat e të gjitha palëve</i>				
	Treguesit: numri i arrestimeve, ndjekjeve, dënimeve, sipas formës së trafikimit, përqindja e viktimave që dalin dëshmitarë, përqindja e proceseve gjyqësore që i mbështesin viktimat me prova të vërtetuara, numri i dënimeve të kryera plotësisht				
1.(a)	OBJEKTIVI SPECIFIK: Rritja e përdorimit të teknikave proaktive të hetimit (përfshi hetimet financiare dhe të pastrimit të parave) në hetimet kundër trafikimit				
	Treguesit: Numri/përqindja e ndjekjeve kundër trafikimit nisur nga provat e siguruara nëpërmjet hetimesh proaktive; numri dhe përqindja e dënimeve të mbështetura mbi prova proaktive				
1.(a).1	Zbatimi i një sistemi menaxhimi të informacioneve të fshehta mbi trafikimin e qenieve njerëzore (mbledhja, analizimi dhe shpërndarja e informacioneve të fshehta), në përputhje me Planin Informativ Kombëtar	Policia e Shtetit, e mbështetur nga ICITAP, PAMECA, dhe SHISH	Mesi i 2010-ës	Përgatitja e raporteve tre mujore të informacioneve të fshehta, analizave të situatës, përcaktimi i profilit të trafikantëve/viktimave	Policia e Shtetit, ICITAP, PAMECA, SHISH
1.(a).1.1.	Forcimi i kapacitetit të Zyrës së Analizës Kriminale për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave nëpërmjet: <ul style="list-style-type: none"> Vënies në punë të sistemit TIMS dhe sigurimit të aksesit të gjitha Drejtorive Rajonale; Trajnimit të të gjithë punonjësve rajonalë të analizës për rritjen e aftësive analitike; Trajnimit të oficerëve kryesorë të policisë 	Policia e Shtetit	Mesi i 2009-ës	Funksionimi i Zyrës së Analizës Kriminale Funksionimi i plotë i bazës së të dhënave për krimet (përfshirë edhe lidhjen në rrjet të sistemit TIMS); Shtrirja e aksesit në TIMS në Sektorin e Anti-trafikimit	Policia e Shtetit ICITAP, PAMECA Policia e Shtetit, ICITAP

Nr.	Veprimtaritë dhe nën-veprimtaritë	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
	për të siguruar mbledhjen e të dhënave.			<p>/Policinë e Shtetit dhe në të gjitha Drejtoritë Rajonale të Policisë së Shtetit (Seksionet kundër Trafiqeve të Paligjshme)</p> <p>Zhvillimi i aftësive analitike në të gjitha drejtoritë rajonale nëpërmjet trajnimit</p> <p>Rritja e aftësisë për mbledhjen e të dhënave nëpërmjet trajnimit të punonjësve të policisë anti-trafik si dhe e personelit kryesor të vijës së parë në çdo Drejtori Rajonale</p>	<p>Policia e Shtetit</p> <p>Policia e Shtetit, ICITAP, PAMECA</p>
1.(a).2	Rritja e njohurive dhe aftësive të nëpunësve të zbatimit të ligjit për teknikat proaktive të hetimit	Akademia e Policisë	Në vazhdim	<p>Numri i oficerëve të specializuar të zbatimit të ligjit, të trajnuar për aplikimin e teknikave të hetimit të orientuara nga informacionet kriminale; nr i punonjësve të zbatimit të ligjit të vijës së parë, të cilëve u është siguruar trajnimi bazë mbi mbledhjen e nivelit të ulët të informacioneve kriminale</p> <p>Synimi: të paktën 1 oficer në secilën Drejtori Rajonale të jetë i njohur me metodën e policimit të orientuar nga informacionet kriminale dhe punonjësit e vijës së parë të jenë të njohur me mbledhjen e informacioneve kriminale të nivelit të ulët</p>	Ministria e Brendshme

Nr.	Veprimtaritë dhe nën-veprimtaritë	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
1.(a).2.1.	Garantimi i përfshirjes së teknikave proaktive të hetimit (në nivel specialisti) në trajnimin kundër trafikimit dhe mbledhjen e informacioneve kriminale të nivelit të ulët (në nivel të përgjithshëm)	Akademia e Policisë	Në vazhdim	Numri i oficerëve të specializuar të zbatimit të ligjit të trajnuar për aplikimin e teknikave të orientuara nga informacionet kriminale; nr i punonjësve të vijës së parë të zbatimit të ligjit, të cilët kanë marrë trajnim bazë mbi mbledhjen e informacioneve kriminale të nivelit të ulët.	Policia e Shtetit
1.(a).2.2	Sigurimi i këshillimit të vazhdueshëm të specializuar Sektorit kundër Trafiqeve të Paligjshme duke ftuar partnerë ndërkombëtarë (Misioni i BE-së për Policinë, SHBA-së) për të vendosur pranë Sektorit kundër Trafiqeve të Paligjshme një OPGJ ndërkombëtar për trafikimin e qenieve njerëzore, mundësisht femër.	Sektorit kundër Trafiqeve të Paligjshme i Policisë së Shtetit në partneritet me partnerët ndërkombëtarë etj.	Fillimi i vitit 2009	Vendosja e një OPGJ ndërkombëtar për trafikimin e qenieve njerëzore pranë Sektorit kundër Trafiqeve të Paligjshme të Policisë së Shtetit OSE mbështetje e vazhdueshme në nivel eksperti këtij Sektori	Policia e Shtetit, PAMECA, ICITAP
1.(a).3	Rritja e përdorimit të hetimeve financiare në hetimet kundër trafikimit (pastrimi i parave, si dhe konfiskimi, ngrirja dhe sekuestrimi i aseteve)	Ministria e Financave/Drejtoria e Përgjithshme kundër Pastrimit të Parave, PP, Policia e Shtetit/Drejtoria kundër Krimit Ekonomik, Doganat	Në vazhdim	Numri i çështjeve të trafikimit përfshirë hetimet financiare, në numra absolutë dhe në përqindje; Numri/sasia e aseteve të konfiskuara dhe të ngrira; Numri i dënimeve për pastrim parash	Ministria e Financave (Drejtoria e Përgjithshme kundër Pastrimit të Parave), PP, Policia e Shtetit
1.(a).3.1.	Forcimi bashkëpunimit për hetimet financiare anti-trafikim midis Njësisë së Inteligjencës Financiare, PP-së, dhe Drejtorisë kundër Krimit Ekonomik në Policinë e Shtetit; përmes trajnimeve/seminareve të përbashkëta dhe	Ministria e Financave në bashkëpunim me PP, Policinë e Shtetit/Drejtorinë kundër Krimit Ekonomik dhe SHISH	Vjeshtë 2008 Fund i vitit 2008	Mbajtja e seminareve Ekzistenca e Procedurave Standarte Operative Zhvillimi i takimeve të rregullta	Ministria e Financave, SHISH

Nr.	Veprimtaritë dhe nën-veprimtaritë	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
	zhvillimit të Procedurave Standarte Operative				
